

Produksioni shqiptar “Open door” vlerësohet me dy çmime në edicionin e 21-të të Festivalit European të Filmit



TIRANË, 9 nëntor /ATSH/ Në festivalin e 21 të Filmit European që u zhvillua në Leçe të Italisë, produksioni shqiptar “Open door” me regji nga Florenc Papas dhe me portagoniste Luli Bitri dhe Jonida Vokshi rrëmbeu dy çmime, Cineuropa dhe çmimin e publikut.

Në festivalin e 21 të Filmit European që u zhvillua në Leçe të Italisë, nga 31 tetori deri në 7 nëntor, Shqipëria u prezantua nga katër projekte kinematografike.

“Delegacioni” nga Bujar Alimani, “Dita zë fill” i Gentian Koçit dhe “Portret i pambaruar” i Namik Ajazit u shfaqën si në këtë festival si pjesë e seksionit Ballkanik.

Kater projeksionet shqiptare kishin një rëndësi të madhe në këtë festival pasi pasqyronin realitetin ballkanik. Kjo ishte edhe arsyeja që juria e festivalit përzgjedhi katër filma shqiptarë pasi kanë ardhur si materiale të cilat përfaqësonin të gjithë këtë rajon dhe problematikat me të cilat qytetarët përballen.

Filmi flet për historinë e dy motrave të cilat ndërmarrin një udhëtim të gjatë për në shtëpinë e babait të tyre dhe shqetësimin që ato kanë për përballjen me të dhe mentalitetin e tij patriarkal.

Tematika e filmit është përballja e dy botëve, brezit të ri që e sheh jetën në mënyrë realiste dhe atë të babait të tyre që është një botë tradicionale dhe konservatore.

Filmi “Open Door” këtë vit përfaqëson Shqipërinë në njërin nga festivalet më të mëdha të globit, sikurse është “Oscars”. /a.a//r.e/

ata.gov.al